

VENDIM
Nr.595, datë 24.8.2011

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.472, DATË 2.7.2011 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR DISIPLINIMIN E PËRDORIMIT TË FONDEVE BUXHETORE,
PËR VITIN 2011”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 16 e 40 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të nenit 10 të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në fund të fjalisë së tretë, të pikës 2 të vendimit nr.472, datë 2.7.2011 të Këshillit të Ministrave, pas fjalëve “...financimet e huaja dhe fondet përkatëse për kosto lokale dhe detyrime tatimore” shtohen fjalët “...fondet buxhetore që shkojnë për blerje të vogla, si dhe fondet e qeverisjes vendore, burimi i financimit të të cilave është transferta e pakushtëzuar dhe të ardhurat e veta.”.

2. Ngarkohen të gjitha institucionet e njëjësive të qeverisjes së përgjithshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha